



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr.1714 /2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Udhëzimi Administrativ Nr.03/2014 për Procedurën e Themelimit , Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë neni 11 paragrafi 3, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit neni 57, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 25.03.2021 merr:

**V E N D I M**  
**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE**  
**PËR VITIN 2020**

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin e punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2020.
2. Duke ju referuar nenit (1) të këtij vendimi pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i punës për vitin 2020 i Komitetit për Komunitete.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Anëtarët e Komitetit për Komunitete,
- Ministria e Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 25.03.2021





01/Nr.603/2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 neni 11, 40, Rregulloren nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, neni 4,5 dhe 15 dhe në bazë të Statutit të Komunës neni 65, 67, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me 25.03.2021 merr:

**V E N D I M**  
**PËR DHËNIEN E PËLQIMIT NË PARIM**

1. I jepet në parim pëlqimi z.Ramushi (Isni) Krasniqi për ndërtimin e objektit për ushtrimin e veprimtarisë biznesore, Restorant në parcelën me numër P-73317015-00076-0 në sipërfaqe prej S=1200 m<sup>2</sup> apo (12 ari) me kulturë kullosë e klasit të 5 (pestë) në vendin e quajtur Ledina , zona kadastrale Vërtomicë pronë shoqërore Ekonomia e Pyjeve.
2. Komuna e Hanit të Elezit në parcelën e lartë shënuar nuk ka të paraparë me plan zhvillimor komunale dhe me plan rregullativ hapësinor ndonjë projekt, kurse pala për dokumentacionet e tjera të nevojshme duhet të drejtohet në Agjensionin e Pyjeve të Republikës së Kosovës pasi që sipas ligjit, “Pyjet dhe tokat pyjore janë pronë e Shtetit të Kosovës”.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.
4. Me këtë vendim njoftohet:  
Kryetari i Komunës,  
Parashtruesi i kërkesës,  
Drejtorja për Bujqësi,  
Drejtorja për Urbanizëm,  
Ministria e Pushtetit Lokal dhe  
Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 25.03.2021





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 1713/2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Udhëzimin Administrativ Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna neni 13 paragrafi 4, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit neni 57, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 25.03.2021 merr:

**V E N D I M**

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË KATËR KOMITETEVE KONSULTATIVE PËR VITIN 2020

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin e punës së katër Komiteteve Konsultative të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020.
2. Duke ju referuar nenit (1) të këtij vendimi pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i punës për vitin 2020 i Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit, Komitetit Konsultativ për Arsim, Kulturë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komitetit Konsultativ për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Komitetet Konsultative,
- Ministria e Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 25.03.2021

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**MSc. Qamush Brava**





Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12, 40, Ligjit Nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, neni 9, paragrafi 9.1, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 27, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datën 25.03.2021 merr këtë:

**VENDIM**  
**PËR TRANSFER TË MJETEVE NGA KATEGORIA EKONOMIKE REZERVA NË**  
**SHPENZIME KAPITALE**

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në shpenzime kapitale.
2. Transferi i mjeteve nga kategoria rezerva në shpenzime kapitale është në shumë prej 55,000.00 € për vitin 2021, në shumë prej 160,000.00 € për vitin 2022, si dhe në shumë prej 270,375.00 € për vitin 2023 nga fondet 10, 21, sipas nën-programeve buxhetore dhe projekteve kapitale.
3. Të transferohen mjetet nga kategoria Rezerva e nën-programit Planifikimi urban dhe inspeksioni (66480) në kategorinë shpenzime kapitale në nën-programin Planifikimi urban dhe inspeksioni (66480), nga fondi 10 dhe 21 në projektet si vijon:

Kodi i proj.	Emërtimi i projektit	Objektivat e projektit	Fondi Burimor	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
I ri	Shtrimi me kubëza betoni nëpër zonat urbane dhe rurale të Hanit të Elezit	(Rr.Gafurr Loku, Rr.Driton Loku, Rr.Udha e Shkronjave, Rr.Rezistenca, Rr.Izet Bushi, Rr.Imer Vila, Rr.Brigada 164, Rr.UÇK, Rr.Dëshmorët e Krivenikut, Rr.Epopeja e UÇK, Rr.Ditura, Rr.Kushtrimi i Lirise, Rr.28 Nëntori, Rr.Suad Brava, Rr.Martirët e Dermjakut)	GQ-10	30,000.00	50,000.00	80,000.00
I ri	Rregullimi i kanalizimeve nëpër zonat urbane dhe rurale të Hanit të Elezit	(Rr.Nehat Curri, Rr.Udha e Shkronajve, Rr.Isa Berisha, Rr.Dheu i Bardhe, Rr.Epopeja e UÇK, Rr.Veteranët e UÇK, Rr.Liria, Rr.Dëshmorët e Krivenikut, Rr.Sharri)	GQ-10	20,000.00	50,000.00	120,000.00

I ri	Rregullimi i shtigjeve për këmbësor dhe çiklistë përgjat lumit Lepenc (Uji i thartë - Kulla me çeshme).		THV-21	0	50,000.00	60,375.00
Totali				50,000.00	150,000.00	260,375.00

**Të transferohen mjetet nga Rezerva e nën-programit:**

Administrata e arsimit (92175), shuma prej 5,000.00 € për vitin 2021,  
 Administrata e arsimit (92175), shuma prej 10,000.00 € për vitin 2022,  
 Administrata e arsimit (92175), shuma prej 10,000.00 € për vitin 2023.

**Në kategorinë shpenzime kapitale në nën-programin Administrata e arsimit (92175), nga fondi burimor 10 dhe 21, në projektin si vijon:**

Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Fondi Burimor	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
I ri	Riparimi i objekteve të trashëgimisë kulturore në fshatin Pustenik	GQ-10	0	10,000.00	10,000.00
		THV-21	5,000.00	0	0
Totali			5,000.00	10,000.00	10,000.00

4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoret e Drejtorive,
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Buxhetit,
- Ministria e Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
 Data: 25.03.2021

